



BASHKIA KRUJË

KRYETARI I BASHKISË

Z. ARTUR BUSHI



PLANI I DETYRUAR VENDOR (PDyV)
PËR ZONËN E RE TË ZHVILLIMIT 1,
NJËSIA ADMINISTRATIVE BUBQ, BASHKIA KRUJË

HARTOI: UNLAB

MARS 2020



Tirane, 09/03/2020

RAPORT

KREU 1. Analiza Territoriale

Pozicioni gjeografik i Njesise Administrative Bubq.

Sitemi Urban (UB)

Sistemi Infrastrukturor (IN)

Sistemi Bujqesor (BU)

Sistemi Natyror (N)

Sistemi Uroj (U)

KREU 2. Strategjia Territoriale

Plani i Veprimeve.

Sitemi Urban (UB)

Plani i Mbrojtjes se Mjedisit

Plani i Infrastrukturave dhe Sherbimeve Publike

Sistemi Bujqesor (BU)

Sistemi natyror (N)

Sistemi uroj (U)

KREU 3. Plani i Detajuar i Zhvillimit te Territorit

Masterplani i zones ne studim.

Rrjeti i infrastrukturave inxhinierike.

Projekti Hidroteknik

Relacion Teknik i Projektit Hidroteknik.

Projekti i Rrjetit Elektrik dhe i Telekomunikacionit.

Relacion Teknik Elektrik.



KREU 4. Rregullorja Detajuar e Planit dhe Udherrefyesi Arkitektonik.

Rregullorja e Planit te Detyruar Vendor

Neni 1: Perkufizimet

Neni 2: Fusha e aplikimit

Neni 3: Lartesia e strukture

Neni 4: Lartesia e katit

Neni 5: Gjatesia minimale e strukturave

Neni 6: Gjeresia maksimale e strukturave

Neni 7: Koeficienti i shfrytezimit te tokes per ndertime

Neni 8: Vija e ndertimit

Neni 9: Distanca midis strukturave

Neni 10: Parkimi

Neni 11: Trajtimi i fasadave te strukturave propozuara.

Pasaportat e njesive strukture te PDyV.



A handwritten signature in blue ink, consisting of a stylized, cursive script.

Objekti: “Hartimi i planit te detyruar vendor (PDyV) per Zonen 1, Njesia Administrative Bubq, Bashkia Kruje”.

FAZA I - Analiza Territoriale dhe Plani i Percaktimeve (Strategjia) Territoriale.

KREU 1. Analiza Territoriale

Pozicioni gjeografik i Njesise Administrative Bubq.

Njesia Administrative Bubq eshte nje prej njesive administrative te Bashkise Kruje. me nje popullsi prej 7235 banore por pa nje projeksion ne rritje te saj. Me nje largesi prej 27 km nga kryeqyteti, 15.5 nga qendra historike e qytetit te Krujes dhe 16 km nga Aeroporti Nene Tereza, Bubqi pozicionohet ne pjesen e ultesires se qytetit te Krujes karakretizuar nga siperfaqe te konsiderueshme tokash bujqesore, por dhe ato te terreneve kodrinore rreze te cilave shtrihet dhe zona ne studim.

Pozicioni gjeografik i Bubqit ofron akses te shpejt me pika te rendesishme turistike si te karakterit malor me Sari Saltik dhe atij detar si Kepi i Rodonit, Lagunen e Patokut, por dhe zona monumentale me vlera historike te cmuara si Kalaja e Krujes, Pazari i Krujes etj.

Afersia e Bubqit me rrugen e shpejtesise se larte Tirane-Shkoder, ofron nje potencial per zhvillimin e aktivitetit industrial dhe tregtare per zonen, sikurse dhe akses direkt dhe mundesi eksplorimi te territorit bujqesor dhe natyror qe perben sistemet me dominuese te territorit ne studim.

Bubqi, ne kushtet aktuale, perfaqeson nje prej zonave te prekura,por pa vinktimave nga termeti i 26 nentorit 2019. Me nje numer total prej 141 familjesh ne emergjence per t’ iu siguruar strehim, zona e rezervuar per rindertim eshte parashikur te kete nje siperfaqe rreth 8.3 ha sipas kufinjve te percaktuar ne Fig. 1.





Fig. 1




Fig.2

Grafiku ne Fig. 2,3 perfaqeson nivelin e demeve te ndertesave ne Njesine Administrative Bubq, ku per qellime planifikimi, do te konsiderohen objekte qe shemben, objektet me Akte Konstatimi me nivel demi DS5 dhe DS4.



[Handwritten signature]



Fig. 3

Analiza e dokumentave të PPV të Bashkise Krujë dhe legjislacionit për territorin e zones subjekt i PDyV, na orienton drejt konsiderimeve të domosdoshme të 5 sistemeve territoriale baze (Fig. 4-Taleba 3 ekstrakt i PPV Krujë) si:

SISTEMI I PËRDORIMIT TË TOKËS	Sipërfaqja ekzistuese	Sipërfaqja e vlerësuar pas aplikimit të projekteve të propozuara
	përqindja %	përqindja %
Sistemi Natyror	45.93	50.43
Sistemi Ujor	1.15	1.29
Sistemi Bujqësor	40.49	38.14
Sistemi Urban	11.67	8.32
Sistemi Infrastrukturor	0.76	1.82
	100	100

Tabla 3 Shpërndarja e sipërfaqes të tokës të Bashkise në pesë sistemet territoriale

Fig. 4



[Handwritten signature]

Sitemi Urban (UB)

Transferimi i banoreve nga zonat me rrezik permbytje ne Bubq eshte nje nga planet afatmesem, ku perkatesisht nje zone prej rreth 8.07 ha eshte parashikuar per kete qellim.

Analiza territoriale per zonen subjekt i kesaj PDyV, nis me analizimin e te gjithes bazes materiale te siguruar nga institucionet e angazhuara ne procesin e rindertimit te zonave te prekura nga termeti i 26 nentorit 2019. Ne kushtet e emergjences qe paraqet nevoja per strehimin e te pakten 141 familjeve, zona e sugjeruar per akomodimin e tyre permbush plotesisht kerkesat e paraqitura ne termat e references duke iu pergjigjur nevojave te familjeve te pastreha ne nje kohe mjaft te shpejte.

Projekti i rindertimit do te shtrihet ne territorin e Zones 1 (Fig.1), te ndare ne dy nenzona me perdorime ekzistuese: Nenzona 1, banim dhe institucione dhe Nenzona 2, momentalisht e perdorur si toke bujqesore do ti rezervohet banesave individuale.



Fig.5

Sikurse eshte parashikuar dhe ne PPV e qytetit te Krujes, ne fragmentin e hartes ne Fig. 5, mund te verehet se ky territor qe perfshin 2 nennjesi strukturore, per BU-UB-023 eshte propozuar te jete subjekt i urbanizimit me perdorimet perkatese qe kjo zone duhet te ofroje, ndersa BU-B-001 i eshte rezervuar sistemit bujqesor. Per shkak se nje siperfaqe e konsiderueshme e pronave ne BU-B-001 jane publike, ky terren u percaktua dhe zona e pershtatshme per rindertimin e objekteve te demtuara.



Sistemi Infrastruktural (IN)

Lidhja e Bubqit me bregdetin.

Projekti pilot per Koridorin e Gjelber te Albanopolis-Lugina e Ishmit-Bregdet, eshte nje prej projekteve qe synon te lidhe Bubqin me zonen bregdetare dhe me shume atraksione te tjera kulturore, arkeologjike dhe peisazhistike. Qellimi paresor i ketij koridori eshte lidhja ekologjike mes zonave te ndryshe te interesit. Aplikimi i levizjes se ngadalte drejt Parkut Rajonal te propozuar per Kodrat e Krastes, Lugines se Ishmit, Kepit te Rodonit, Lagunes se Patokut etj. Aksese permes korsive teresisht te dedikuara bicikletave eshte nje prej propozimeve per kete koridor (Fig. 6).




Fig. 6 (Ref. Plani i Pergjithshem Vendore-Bashkia Kruje)

Analiza e propozimeve te PPV se qytetit te Krujes propozon projekte mjaft ambicioze per Njesine Administrative Bubq ku prioritete jane: shtimin e linjave te transportit urban si linja 3, e cila fillon ne Qereke, Fushe Kruje, Borizane, Bubq, si dhe ai i permiresimit te rrjetit teknik te rruges Bubq-Burdull-Peze, Bubq-Thumane dhe Bubq-Bregdet. Nga keto projekte afatmesme infrastrukturore prithshmerite jane permiresimi i fluksit te levizjes, rritja e prodhimit dhe rritja e shkembimit ekonomik.

Ujesjelles-kanalizime jane nje tjeter prioritet i PPV ku domosdoshmeria e modernizimit te ketij rrjeti ka per qellim ndertimin, funksionimin dhe mirembajtjen e vazhduar me qellim furnizimin me uje 24 ore te zonave te banuara. Per sa i perket sistemeve te ujitjes propozohen sisteme kolektive eficente me qellim menaxhimin dhe racionalizimin e resurseve ujore duke shfrytezuar dhe mundesite e perdorimit te sistemeve te energjise se rinovueshme. Perverc orientimeve te pergjithshme te dhenat specifike per Bubqin rezultojne te indikojne se vetem 60% e zones se banuar eshte e mbuluar nga infrastruktura e nevojshme per furnizimit me uje. Lind nevoja dhe per rehabilitimin e rezervuarit, stacionit te pombimit dhe e linjes se jashtme. Teknologjia e propozuar per kete eshte ai me ngritje mekanike duke konsideruar edhe strukturat shtese si: tubacione, sisteme pompimi dhe pika te tjera kontrolli.

Konsiderimet e pergjithshme te PPV Kruje, rezultojne te paraqesin nje gjendje ekzistuese te amortizuar te rrjetit elektrik, i cili ka nevjje per nderhyrje ne aspekte te ndryshme te tij.

Telekomunikacioni sikurse dhe ne periferite e tjera te qytetit te Krujes, rezulton inekzistente. Per kete plani strategjik, per shkak dhe te nevojave te teknologjise se transmetimit, parashikon realizimin e instalimit te fibrave optike. Gjithashtu per nevojat e nderlidhejs sa me efikase te bizneseve, institucioneve publike, shkollave dhe te tjera



perdorimeve te zonave te qendres, rekomandimet per rrjetet e tekunikacionit sugjerojne perdorimin dhe te "Wireles Access Poin".

Sistemi Bujqesor (BU)

Lidhur me shperndarjen aktuale te territorit te Bashkise se Krujes, pjesa me e madhe e siperfaqes se territorit mbulohet nga toka bujqesore dhe e kultivuar. Toka bujqesore shtrihet pergjithesisht ne perendim, ne zonen e Ultesires Perendimore dhe eshte nje burim i rendesishem ekonomik per zonen. Nje prioritet kryesor i studimit eshte mbrojtja maksimale e tokes bujqesore dhe menaxhimi i qendrueshem i saj.

Ky element dominues gjendet dhe ne njesise administrative Bubq, me siperfaqe te konsiderueshme tokash bujqesore. Ai perben perdorimin me te madh te territorit dhe nje nga perparesite e planit te zhvillimit te PPV Kruje. Nje nga kulturat kryesore te zones eshte dhe vreshtaria dhe kiwi.




Fig.7

Prodhimtaria e larte e ketyre tokave dhe aksesimi mjaft i mire me infrastrukturen rrugore, perbejen nje faktor ekonomik te rendesishem per Bashkine e Krujes. Nje nga strategjite e zhvillimit ekonomik sipas PPV per zonen eshte dhe mbeshtetja e sistemit bujqesor dhe nxitja permes modernizimit te tij fale turizmit bujqesor. Ruajtja, konsolidimi, modernizimi. Aksi ekonomik tashme ekzistues, garanton vazhdimesi dhe konsolidim te ketij aktiviteti fale propozimeve te zonave rezervuar aktivitetit industrial me ndotje te ulet, aktivitete te prodhimit, industrise se lehte, shitjes dhe sherbimeve. Pervet nxitjes se prodhimit bujqesor biologjik edhe i ndertimit te objekteve te



A handwritten signature in blue ink, located at the bottom right of the page.

logjistikës për mbledhjen, ruajtjen, ngrirjen dhe shpërndarjen e produkteve ushqimore vendore, është një ndër prioritetet e përcaktuara për këtë sektor. Modernizimi i këtij sektori konsiston edhe në promovimin e krijimit të qendrave të kërkimit dhe trajnimit për agrobiznesin, krijimin e strukturave hoteliere në nxitje të fshatrave ekologjike që nxisin agroturizmin.

Sistemi Natyror (N)

Resurset natyrore të qytetit të Krujës përbehen vecanerisht nga sipërfaqet pyjore të shtrira në relievin kodrinor dhe malor të këtij territori. Orientimet e zhvillimit të qytetit dhe fshatrave përreth kanë për qëllim shtimin e këtyre sipërfaqeve, nxitjen e biodiversitetit dhe shfrytëzimin e kësaj iniciative për uljen e ndotjes së shkaktuar nga industritë ekzistuese të zonës. Ndërtimi dhe menaxhimi i rrjeteve ekologjike si akse ndërlidhëse mes zonave me vlera të çmuara natyrore, qofshin këto drejt peisazheve malore apo atyre bregdetare, është gjithashtu një ndër prioritetet e PPV. Menaxhimi i mbetjeve është një prej prioritetëve në këtë sektor, duke marrë parasysh mangësitë e sistemit ekzistues jashtë standarteve.

Sistemi Uroj (U)

Sistemi ujor i Bubqit me teresinë e sistemit të vaditjes së tokave bujqësore, rrjetit të ujësjellesit dhe Liqenit të Bubqit përbejnë një prej resurseve të çmuara të këtij territori. Stimulimi i mirëmbajtjes, uljes së ndotjes, mbrojtja nga erozioni dhe ndikimi i njeriut janë direktivat e Planit të Zhvillimit për Bashkinë e Krujës duke përfshirë të gjitha fshatrat rreth saj.

Zonat baferike të sistemit ujor janë një prej elementeve më delikate dhe të papërcaktuara qartë në territor, por fal rregulloret e PPV ato gjejnë tashmë një plan të qartë për konservimin e distancave të nevojshme vecanerisht me ndërtimet, apo dhe specifikime të tjera të nevojshme dhe në mjedisin natyror. Luginat e lumenjve vecanerisht, sugjerohet të trajtohen si koridore të gjelbërta me mundësi shtrirje dhe komunikimi me të tjerë elemente natyrore të rendesishme si liqene, vendbanime, territoret malore apo bregdetare.



KREU 2. Plani i Percaktimeve (Strategjia) Territoriale.

Plani i Veprimeve.

Duke konsideruar te gjitha reflektimet e kryera mbi dokumentacionin dhe legjislacionin e materialeve baze, strategjia qe do te udheheqi projekt propozimin per Njesine Administrative Bubq, mbeshtet ne strategjite e zhvillimit qe do te ndertohen per secilin prej sistemeve si:

Sistemi Urban (UB)

Hapi i pare i referohet planit te ri te perdorimit te tokes. Ne kuader te procesit te rindertimit, urbanizimi i nenzones 1 do te krijoje mundesi me te mira per banoret e saj per te perfituar nga infrastrukturat e nevojshme. Ne kuader te vizionit te ri, urbanizimi i kesaj zone percakton perdorime te reja te territorit, sic eshte dhe transformimi i nje pjese te BU-B-001, nga toke bujqesore ne zone urbane. Gjithashtu dhe territori urban ekzistues, BU-UB-023 do te pesoj ndryshime per shkak te perdorimeve specifike te grupeve te reja te parcelave. Per kete arsye, duke iu referuar "Vendim_i_KM_671_29.07.2015", dhe propozimeve te perdorimit te tokes se PPV Kruje, zona ne studim do ti nenshtrohet ndarjes se re strukture sipas hares ne Fig. 8.



Fig.8

Kodifikimi i ndarjes se re territoriale te zones ne studim, sic mund te vihet re, per efekt thjeshtimi, do ti referohet kodit te njesise strukture ekzistuese BU-UB-023, duke e



ndare ate ne7 nennjesi te tjera me te vogla per shkak te cilesive te dallueshme te tyre nga njera tjetra si: perdorimet, tipologjite e strukturave ndertimore te ndryshme, treguesit zhvillimore te ndryshem.

Hapi i dyte i referohet planit te prishjeve, I cili do te kryehet ne faza ku:

- 1) Faza e pare konsiston ne prishen e objekteve te demtura nga termeti me nivel demi DS4 dhe DS5, te paraqitura me ngjyre portokalli ne harten ne Fig.10,
- 2) Faza e dyte do te mundesoje prishjen e te gjitha objekteve ne pronen publike dhe atyre qe ndodhen ne gjurmjet e rrjetit rrugor te propozuar, per ti lene vend planit te ri te infrastrukturave dhe sherbimeve publike.





Fig.10-Plani i prishjeve ne faza.

- 1) Faza e trete do te jete faza finale e prishjeve te objekteve ekzistuese ne nennjesine strukturore BU-UB-023/4, duke i hapur rrugen krijimit te parkut te ri te Bubqit.Fig.11.



[Handwritten signature]




Fig.11-Plani i prishjeve ne faza.

Hapi i trete i planit te veprimit, i referohet aksionit te menjehershem per ndertimin e banesave kolektive per strehimin e 15 familjeve, duke konsideruar pranine e infrastrukturave ekzistuese ne vendin e percaktuar per to, si dhe perdorimin e truallit prone publike.

Hapi i katert i referohet nenzones 2, ku do te sistemohen parcelat per strehimin e 78 familjeve ne banesa individuale. Perkatesisht ky territor, prej rreth 40372 M2 do te mundesoje strehimin e 30 banoreve ne banesa individuale 1+1, 108 banoreve ne banesat individuale 2+1 dhe 108 banoreve ne banesat individuale 3+1. Ne total e gjithë nenjesia strukturore BU-UB-023/02 do te strehoje 246 banore.

Hapi i peste perfshin ndertimin e polit administrativ, ne piken hyrese te Njesise Administrative Bubq. Nennjesia BU-UB-023/01, me nje siperfaqe rreth 10385 m2, do te jete territori qe do te akomodoje keto funksione. Ne parcelen ku lokalizohen zyrat ekzistuese te Njesise Administrative Bubq si dhe shkolla e Bubqit, do te rindertohen objektet me te njejtat funksione, por tashme duke funksionuar si nje ansambel ndertesash adminstrative, me sheshe dhe hapësira te gjelberta te shtuara rreth tyre.

Objekti qe do te akomodoj zyrat e Administrates Publike, Postes, Policise dhe te tjera njesi sherbimi publik sipas nevojës, do te kete nje siperfaqe mbulimi prej rreth 1076 m2. Me nje lartesi te lejuar prej vetem 1 kat, perpara tij pozicionohet sheshi qendror me siperfaqe te gjelberuara, i cili shtrihet me perdorime te ndryshme te tij edhe ne anen jugore te nennjesise, duke u konturuar nga te tjera ndertesa institucionale. Ky shesh fale aktiviteve te variueshme qe mund te akomodoje si: treg pakice, hapësira



ekspozimi produktesh lokale dhe aktivitete kulturore te ndryshme, do te ofroje nje moment hyrje ne Njesine Administrative Bubq mjaft atraktiv. Ky territor mund te transformohet ne nje hapsire teresisht pedonale, duke limituar aksesin e automjeteve ne segmentin rrugor qe e pershkron ate, per ta devijuar ne dy rruget e tjera kufitare hyrese ne jug te zones.


Parcela ne jug te nenjesise BU-UB-023/01, do te akomodoje te tjera sherbime publike si: Qender Shendetesore, Banka, Qender Komunitare, Atelie artizanesh dhe njesi sherbimi.

Planin e Mbrojtjes se Mjedisit

Hapi i gjashte perfaqeson nderhyrjen finale ne rindertimin e zones pas katastrofes. Ky hap vjen si rezultat i finalizimit te te gjitha fazave te prishjeve dhe pas permbushjes se prioriteteve paresore: akomodimi i familjeve te pastreha dhe ndertimi i infrastruktures dhe sherbimeve publike te nevojshme per zonen. Ne nnjesia BU-UB-023/4 eshte parku qendror i propozuar per zonen e rindertimit. Me nje siperfaqe prej 8009 m² qelberim komakt dhe rreth 43 peme te mbjella ne kete hapesire rekreative, banoret e Bubqit do te kene mundesine te perfitojne jo vetem nga keto siperfaqe te gjelberta te shtuara per zonen, por dhe nga kende lojrash dhe hapesirat e takimit ftuese qe do te shterbejne per grumbullimin e komunitetit ne aktivitete te ndryshme social-kuturore.

I aksesueshem ne pak metra dhe ne distanca te barabarta nga cdo pike e zones ne studim, parku qendror perben vetem nje prej disa elementeve mjedisor atraktiv te zones. Sikurse propozuar dhe ne planin e infrastrukturave, permes koridoreve te gjelberta dhe korsive te bicikletave kjo hapesire rekretative perben nje prej elementeve te kurores se gjelbert qe konturon kete territor.

Referuar imazhit ne Fig.12 eshte e qarte se terreni bujqesor ne lindje, jug dhe perendim te zones, siperfaqet pyjore ne perendim dhe jug, si dhe burimi uhor ne afersi, perbejne element mjaft atraktiv me imfakt te konsiderueshem mjedisor. Per kete arsye nxitja e koridoreve ekologjike per nderlidhjen e vazhduar mes tyre ofron perfitim per komunitetin duke kaluar nga nukli me i vogel, ai i parkut qendror te bllokut, ne ate natyror ne jo me shume se 1 km largesi.






Fig.12-Koridoret ekologjike

Sistemi Infrastrukturor (IN)

Teresia e rrjetit infrastrukturor eshte orientuar nga propozimet e PPV duke rikonsideruar akseset me njesite e tjera Administrative me qellim nxitjen e aktivitetit ekonomik, bujqesor dhe ate te agroturizmit. Rrjeti rrugor i propozuar per zonen ne studim, mbeshtetet ne gjurmen e rrugeve ekzistuese, duke nderhyre ne permiresimin dhe zgjerimin e tyre, sikurse dhe shtimin e akseve te reja te qarkullimit automobilistik dhe te bicikletave. Gjithashtu shtimi i ndricimit rrugor plotesisht inekzistent si dhe gjelberimit rrugor eshte nje nga propozimet e planit te infrastrukturave.

Nenzona 1 eshte e lidhur direkt me Rrugen Nacionale ekzistuese, por ne planin e propozuar te infrastrukturave keto akseset do te shtohen dhe permiresohen me te gjithë elementet e nevojshem te sigurise rrugore, permes rrugeve te kategorise F me seksion 10 m, si ne Fig.13.

Rrugët e aksesit per nenzonen 2 do te jene kryesisht rruge te kategorise E: me levizje te automjeteve ne dy drejtime dhe rrugeve me nje sens levizje dhe parkime publike ne nje drejtim. Permes nje rrjeti rrugor ortogonal, qarkullimi i automjeteve lehteson fluksin e qarkullimit duke levizur ne nje drejtim permes sistemeve unazore te vogla te rrugeve me seksion 8.5 m dhe 7m.







Fig.13

Sistemit infrastrukturor te propozuar i shtohen dhe akseset te reja pedonale dhe ato te bicikletave. Keto koridore te qelberta, te levizjes se ngadalte do ti sherbejne jo vetem banoreve te zones, por dhe vizitoreve ditor te saj, duke ofruar komunikim me: territorin bujqesor ne afersi te zones ne studim, strukturat e ndryshme te agroturizmit si dhe me mjediset natyrore te njesive kufitare.

Nje aks i ri i rendesishem i propozuar si kilometri i pare i kesaj iniciative eshte korsa e bicikletave e propozuar ne jug te zones ne studim, ne kufijte e vijes blu te mjedisit natyror te perroit. Ajo propozohet te nxis aksesin ne territorin bujqesor dhe natyror ne lindje dhe jug te Njesise Administrative te Bubqit si ne skemet ne Fig.14 si dhe te sherbej si nje shetitore plotesisht pedonale ne kufinjt e zones.






Fig.14

Sistemi Bujqesor (BU)

Saj nderhyrjes per urbanizimin e zones se qendres dhe transferimin e banoreve nga banesat e demtuara nga termeti i 26 nentorit ne kete zone, nje pjese e konsiderueshme e territorit bujqesor do ti destinohet ndertimeve te banesave individuale.

Ky territor qe perfaqeson dhe siperfaqen me te madhe te Bashkise Kruje, i pozicionuar pikerisht ne Ultesiren Bujqesore, mund te modernizohet dhe rigjenerohet permes nderhyrjeve te nevojshme per ti trasformuar ato ne zona atraksioni per agro dhe ekoturizmin. Ky fenomen tashme i aplikuar ne te gjitha ultesiren bujqesore te zones mund te shbej si nje faktor i rendesishem ekonomik per Bubqin, jo vetem ne nivel sherbimi hotelier, bujtinash, koridoreve te gjelberta ekologjike por dhe ate te tregtimit te produkteve lokale.

Sistemi natyror (N)

Nen te njejten strategji te zhvillimit te turizmit per zonen bujqesore dhe ajo natyrore duhet te jete hallka pasardhese lidhese e trajektoreve te kembesoreve, per te siguruar vazhdimesi ne njohjen dhe eksplorimin e vlerave natyrore te terrenit me qellim nderthurjen e tyre me eksese ne zonat e banuar me vlera historike, tregetare e pisazhistike. Nxitja e pyllezimin dhe biodiversitetit duhet te jete nje prej strategjive te ndjekura per rivleresimin e peisazhit natyror te zones, te cilat duke konsideruar efektin e industrive ekzistuese te zones, do te ndikojne dhe ne uljen e ketij impakti ndotes.



Sistemi uroj (U)

Qellimet e strategjise se zgjedhur per teresine e sistemit vadites te tokave bujqesore ne Fushat e Bubqit, Liqenin e Bubqit, dhe ne te gjithë mjedisin natyror te zones, ne Bubq dhe vecanerisht ne zonen subjek i hartimit te PDyV, jane stimulimi, rigjenerimi, mirembajtja e vazhdueshme dhe modernizimi permes aktivitete te ndryshme qe do te nxisin rivleresimin e ketyre hapësirave. Aktivitet sportive mund te jene nje prej tyre, duke ofruaj pasurimin me eksperienca te reja, qe i shtohen kalimeve ekskursioniste ne koridoret ekologjike dhe te agroturizmit, nga qendra te tjera kufitare me drejtim Bubqin dhe Liqenin e Bubqit. Rigjenerimi i sistemit natyror dhe rikualifikimi i burimit ujqor ne kufinjte jugor te zones, mund te perfaqesojne nje plan afatmesem per kete territor, me qellim shtimin e siperfaqeve te gjelberta dhe te akseseseve te banoreve ne to.



KREU 3. Plani i Detajuar i Zhvillimit te Territorit

Masterplani i zones ne studim.



Fig.15

Ky masterplan vjen si nevojë e strehimit të banoreve të Njesise Administrative Bubq pas gjendjes së fatkeqesise të shkaktuar nga termeti i 26 nëntorit 2019. Duke ju referuar gjendjes ekzistuese të përdorimit të tokës për zonën në studim, dhe funksioneve ekzistuese për nënzonen 1, u gjykua që rindërtimi i Bubqit të nis përkishtë nga nukli administrativ. **BU-UB-023/01** do të jetë hyrja e re e zonës me një akses teresisht pedonal, duke mundësuar devijimin e qarkullimit të automjeteve në akset rrugore në jug të zonës. Kjo hyrje e re karakterizohet nga **sheshi qendror** me një sipërfaqe rreth **971 m²** dhe **1892 m² sipërfaqe të gjelberta**, një hapësirë kjo që i kishte munguar Bubqit.

Poli i ri administrativ me një sipërfaqe totale ndërtimi rreth **2308 m²**, do të përfaqësohet nga dy ndërtesa me një lartësi 1 deri në 2 kate maksimumi, të cilat do të konturojnë sheshin qendror. Në këto objekte do të akomodohen të gjitha shërbimet administrative, shëndetësore, social-kulturore dhe tregtare të nevojshme për banorët e zonës, të shtrira këto në një territor rreth 3000 m² krejtësisht pedonal, i aksesueshem dhe i depertueshem në 360 grade.



[Handwritten signature]

Banesat kolektive te konceptuara ne dy blloqe perkatesisht ne nenjesiste **BU-UB-023/02** dhe **BU-UB-023/06** do te jene hapesirat ku do te ndertohen tre tipologji te reja banesash kolektive, te konceptuara ne tre kate lartesi ato do te ofrojn nje numer total prej **45 apartamentesh**. Perkatesisht ne keto banesa do te sistemohen **30 banore ne apartamentet 1+1, 54 banore ne apartamentet 2+1 dhe 48 banore ne apartamentet 3+1**. Keto blloqe banimi karakterizohen nga siperfaqe te konsiderueshme rekreative dhe te gjelberta ne sheshet brenda komplekseve si dhe aksese te mjaftueshme ne parkimet publike.

Banesat individuale te sistemuara ne nennjesine **BU-UB-023/03** do te strehojne ne total **102 banore ne 78 njesi banimi**. Parcelizimi i ketij territorit, perpos prioritetit te strehimit ishte i orientuar edhe nga nevoja per hapsira te gjelberta dhe rekreative publike. Ne nje siperfaqe te limituar, dhe duke konsideruar aksesin e afert me parkun qendror, bllokut te banesave individual ju bashkangjiten pasazhe te gjelberta ne te gjitha territorin e tij. Sikurse paraqitur ne Fig.16 keto aksese teresisht pedonale, ofrojne hapesira te gjelberta ne afersi te bllokut, ku elemente te mobilimit urban si stola dhe kende te vogla lojerash do te jene nje tjetër vlerë e shtuar per zonen dhe banoret.




Fig.16



Parku qendror me nje siperfaqe totale te gjelber prej **8009 m2** dhe **dhjetra peme** te mbjella, do te shtrihet ne territorin natyror kodrinor ne qender te zones ne studim. Ky park pervec siperfaqeve te konsiderueshme te rezervuara per **kende lojrash** ne terracimet e ndryshme te tij, do te ofroj dhe nje **amfiteater** te vogel ku banoret mund te marrin pjese ne shfaqe te ndryshme, por dhe thjesht ta shfrytezojne ate si hapesire shplodhese. Nje vlere e shtuar per kete territor nuk eshte vetem rigjenerimi i tij, por dhe aksesueshmeria drejt tij edhe ne piken me te larte te terrenit kodrinor, permes rampmave qe konturojne te gjithë parkun dhe amfiteatrën.

Blloku ekzistues e banesave individuale ne nennjesine **BU-UB-023/05**, do ti nenshtrohet nderhyrjeve rigjeneruese duke pasuruar kete territor me rreth **870 m2 siperfaqe te gjelberta te shtuara**.

Se fundmi, **kompleksi shkollor** ne nenjesine **BU-UB-023/05**, eshte infrastruktura e re shkollore qe do ti ofrohet Nenjesise Administrative Bubq. Ne nje ndertese 2 kate te larte dhe rreth 4000 m2 siperfaqe te ndertuar, do te ofrohen mjedise mesimore per rreth 650 nxenes. Ky kompleks i ri shkollor do te ofroj rreth **550 m2 siperfaqe te gjelberta, terrene sportive ne 555 m2** dhe mjedise te tjera rekreative si dhe hapesira parkimi.




Fig.17



[Handwritten signature]

Rrjeti i infrastruktures rrugore perbehet nga aksi kryesor i levizjes me dy sense veri-jug, me seksion 8.5 m dhe 7.5 m, sipas seksioneve ne Fig.13. Akset automobilistike hyrese per ne zonen ne studim do te devijojn ne dy akseset ne jug, per te transformuar aksin ekzistues ne zone teresisht pedonale. Sikurse mund te verehet ne Fig.17, rrjeti rrugor i propzuar per bllokun e banesave individuale eshte i perbere nga rruge me 2 sense levizje me seksion 8.5m dhe rruge me nje sens dhe pa parkim rrugor, me seksion 7m.

Infrastruktura Inxhinierike.

Projekti Hidroteknik

Kanalizimet e ujrave te shiut.



Fig.18



Kanalizimet e ujrave te ndotura.



Fig.19



[Handwritten signature]

Kanalizimet e furnizimit me uje te pijshem.




Fig.20



Relacion Teknik i Projektit Hidroteknik.

Te pergjithshme

Projekti i furnizimit me uje konsiston ne ndertimin e nje impianti i cili do te beje te shpendarjen e ujit nga nje rezuervuar ne forme kullet dhe dergimin me vete rrjedhje ne ne te gjithë rretin e furnizimit me uje.

Zona ku do te shtrihen linjat kane nje disnivel te mjaftueshem ne kuote. Kuota maksimale eshte ajo e kullës furnizuese, ndersa kuotat me te ulta ndodhen ne objektet qe do te furnizohen nga ky sistem. Zonat ku do te kalojne linjat jane pa bimesi ose me bimesi te ulet. Presionet maksimale qe do te arrihen ne kete linje nuk do te jene me te medha se 10 atmosfere.

Burimi i furnizimit te rezervuarit do te jete nga linja ekzistuese e sitemit te furnizimit me uje dhe nga aty me ngritje mekanike do te shkoje ne drejtim te rezervuarit te ri i cili do te sherbeje per te furnizuar me vete rrjedhje te gjithë skemen e projektuar.

Skema dhe elementet perberes te sistemit

Rrjeti shperndares do te kete skemen e nje sistemi te kombinuar te mbyllur dhe te hapur te furnizimit me uje ku per sigurimin e prurjes se kerkuar dhe presioneve te nevojshem tek konsumatorët shfrytezohet renia natyrale e terrenit. Si rrjedhim ky sistem do te punoje me veterrjedhje.

Nga rezervuari ne forme kulle del tubacioni i furnizimit me uje. Gjatesia e ketij tubacioni deri ne piken e lidhjes me rrjetin e mbyllur do te jete rreth $L = 250$ ml. Ndersa tubacioni i cili do te dergoje ujin tek konsumatorët do te kene gjatesi te variushme (shif vizatimet teknike).

Elementet perberes te sistemit jane:

- Tubacionet e sistemit
- Rezervuar ujembajtes per linjat me vete rrjedhje
- Pompa per raste nevojë ne shkolla
- Ajruesit
- Rekorderi dhe pasije mekanike

- Rrjeti perbehet nga tubacionet plastike me material polietileni me dendesi te larte (i kategorise PE100) dhe nga saraçineskat e manovrimit si dhe rekorderi. Saraçineskat e manovrimit do te jene prej gize sferoidale (si ne specifikimet teknike) dhe do te jene te pajisura me aks vertikal komandimi (spindle), i cili do te komandohet (manovrohet) nga nje volant brenda nje kutie me kapak e gjitha prej gize sferoidale, te vendosura si ne vizatime. Alternative tjeter e saraçineskes me aks vertikal (SAV) eshte ndertimi i nje pusete te veçante per çdo saraçineske, por jo ndertimi i pusetes se perbashket te manovrimit. Pikat e lidhjeve me ndertesat do te jene ne murin



perimetral te objekteve, ne piken e vendosjes se kutise se aparatit ujemates dhe saraçineskave dhe pajisjeve te tjera brenda kutise (kutia e aparatit ujemates dhe e elementeve te tjere brenda saj do te jete pjese e projektit hidrosanitar te ndertesës).

Llogaritjet hidraulike e sistemit

Perdoruesit e ujit

Para fillimit te llogaritjeve jane percaktuar perdoruesit e ujit dhe kerkesat per uje te tyre si dhe karakteristika apo elemente, te cilet kontribuojne ne permasimin e pjeseve te sistemeve. Ne sistemin e ujit sanitar rol kryesor luajne konsumatorët , meqenese perdorues te tjere te medhenj, nuk jane parashikuar te furnizohen nga ky sistem. Mund te kete sherbime te tjera te cilat nuk ndikojne ne ecurine e kerkeses se pergjithshme per uje.

Numri i kosumatoreve, parashikohet te jete rreth 500 banore, dhe 650 nxenes. Bazuar ne kerkesat e detyres se projektimit, normat mesatare te furnizimit me uje do te jene perkatesisht $n = 120 \text{ l/banore} \times \text{dite}$. Koeficientet ditore dhe orare jane pranuar sipas standardeve teknike per keto lloje perdoruesish. Koeficienti orar llogaritet me formulën e Gibbs ($kd = \frac{5}{(N \times 10^{-3})^{1/6}}$). Ne tabelen e meposhtme jepen te permbledhura vlerat e ketyre te dhenave per furnizimin me uje sanitar:

Nr. i konsumatoreve	Tipologjia	Norma mesatare [l/ban x dite]	Koeficienti ditore	Koeficienti orar
500	Puntor	150	1.3	3.0

Kerkesa per uje te sanitar dhe percaktimi i prurjeve llogaritese

